



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Ligji Nr. 02/L-80

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2003/7
PËR LËNDËN ARKIVORE DHE ARKIVAT

Kuvendi i Kosovës,

Në bazë të Kreut 5.1 (e) dhe 9.1.26 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr 2001/9 të datës 15 maj 2001),

Duke pasur parasysh nevojën për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për lëndën Arkivore dhe Arkivat nr. 2003/7 i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/20 të datës 23.06.2003, lidhur me ndryshimin e pozitës së mbikëqyrjes së Arkivit të Kosovës nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në kuadër të Qeverisë së Kosovës,

Miraton:

LIGJIN PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2003/7
PËR LËNDËN ARKIVORE DHE ARKIVAT

Neni 1

Në Ligjin për Lëndën Arkivore dhe Arkivat nr. 2003/7 të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/20 të datës 23.06.2003 neni 7.5 fjalët: "Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit" zëvendësohet me fjalët: "Qeveria e Kosovës - zyra e Kryeministrit".

Neni 2

Në nenin 7.5.1. fjalët: "Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit" zëvendësohet me fjalët: "Qeveria e Kosovës - zyra e Kryeministrit".

Neni 3

Në nenin 9.2 fjalët: "Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit" zëvendësohet me fjalët: "Qeveria e Kosovës - zyra e Kryeministrit".

Neni 4

Në nenin 10.4. fjalët: “Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit” zëvendësohet me fjalët: “Qeveria e Kosovës - zyra e Kryeministrit”.

Neni 5

Në nenin 13. fjalët: “Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit” zëvendësohet me fjalët: “Qeveria e Kosovës - zyra e Kryeministrit”.

Neni 6

Në nenin 21.2 fjalët: “Ministri për Kulturë” zëvendësohet me fjalën: “Kryeministri”.

Neni 7

Në nenin 24.1 fjalët: “Ministria e Kulturës” zëvendësohet me fjalët: “Qeveria e Kosovës - zyra e Kryeministrit”.

Neni 8

Në nenin 25.2.3 fjalët: “një përfaqësues nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit” zëvendësohet me fjalët: “një përfaqësues i Qeverisë së Kosovës”.

Neni 9

Në nenin 27.1 fjalët: “Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit” zëvendësohet me fjalët: “Qeveria e Kosovës - zyra e Kryeministrit”.

Neni 10

Pas nenit 27.2 shtohet paragraf i ri 27.3 si vijon:

“27.3. Drejtorja e Arkivit të Kosovës dhe Arkivi i Kosovës janë në varshmëri të Qeverisë së Kosovës - zyrës së Kryeministrit, ndërsa Arkivat ndërkomunale dhe komunale janë në varshmëri të Drejtorisë dhe Arkivit të Kosovës”.

Paragrafi ekzistues 27.3 i Ligjit bëhet paragrafi 27.4.

Neni 11

Ky Ligj hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Kosovës dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Ligji Nr. 02/L-80
13 korrik 2006

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,

Kolë Berisha